



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA/
REPUBLIC OF KOSOVO
KOMUNA SHTIME/ OPSTINA-STIMLJE/ MUNICIPALITY OF SHTIME
ZYRA E KRYETARIT/KANCELARIJA PREDSEDNIKA/MAYOR'S OFFICE

Nr. i Protokollit: 02/ 685
24/06/2025

Procesverbal nga dëgjimi publik me banorët e fshatit Mollopolc

E premte, më 13 qershor 2025

Kohëzgjatja e takimit: 19:45- 21:30

Vendi i takimit: SHF "Bajram Curri"

Pjesëmarrës në takim ishin: Kryesuesi i Kuvendit - Adnan Ademi, Drejtori i drejtorisë për Planifikim Urban Kadastër dhe Gjeodezi – Grejtalb Emini, Drejtori i drejtorisë për Shërbime Publike – Bardhyl Rushiti.

Rendi i ditës:

1. Korniza Afatmesme Buxhetore 2026-2028

Kryesuesi i Kuvendit, Adnan Ademi : Ne sot jemi këtu së bashku me Drejtorin e Urbanizmit, Grejtalb Emini, Drejtorin e Shërbimeve Publike, Bardhyl Rushiti si dhe Gentiana Mehmetin e cila është pjesë e kabinetit tonë. Sot jemi këtu edhe një herë për draft- kornizën afatmesme buxhetore për vitin 2026, që i bie kërkesat të cilat ju sot i keni do t'i vendosim në buxhet më pas do t'i votojmë në shtator dhe vitin tjetër do të fillojë implementimi i tyre.

Buxheti i Komunës së Shtimes është 11.5 milion euro, po ju duhet të dini që diku mbi 50% e buxhetit shkon në paga dhe mëditje, ndërsa pjesa tjetër ndahet në kategori tjerat siç janë subvencionet, mallra dhe shërbime e kështu me radhë.

Tek investimet kapitale i kemi afërsisht 2.5 milion euro dhe këto investime janë të ndara në mënyrë proporcionale dhe të barabartë për të gjithë fshatrat pa dallime.

Fatmirësisht ne kemi marrë buxhet nga niveli qendror, projekte të mëdha të cilat nuk dua t'i numroj pasi që i dimë që të gjithë dhe është duke u punuar gjithandej.

Unë nuk dua ta zgjasë edhe shumë pasi që ne sot jemi këtu që t'i marrim kërkesat e juaja si banor të fshatit Mollopolc dhe të bashkëbisedojmë së bashku se çfarë duhet të bëjmë për vitin 2026.

Kërkesat e banorëve të fshatit :

- **Fitim Ismailji:** Të hiqet pengesat të cilat janë të vendosura në rrugë.
- **Ismet Salihu:** Rregullimi i oborrit të kullës.
Objekti i shkollës së vjetër duhet të rrënohet.

Është një rrugë diku afër 800m ku ushtria e UÇK-së ka kaluar andej, nëse ka mundësi ajo rrugë të rregullohet do të ishte mirë.

- **Mentor Neziraj:** Transporti publik për fshatin Mollopolc.
- **Alban Neziraj:** Të rregullohet pjesa që është dëmtuara nga motokrosat të kthehet në gjëndjen e siç ka qenë.

Procesmbajtës,
Gentiana Mehmeti





REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA/
REPUBLIC OF KOSOVO



KOMUNA-SHTIME/OPŠTINA-ŠTIMLJE/MUNICIPALITY OF SHTIME

Lista e pjesëmarrësve në dëgjimin publik në: Hollopolc
Date: 13.06.2025

Nr	Emri dhe Mbiemri	Nenshkrimi
1	MENTOR NEZIRAJ	Mentor
2	Reshat Myjota	Myjota
3	Alban Neziraj	Alban
4	Abdullah Isufaj	Abdullah
5	Ismet Solihu	Ismet
6	KOSOVAR ROSHAT	Roshat
7	FITI ISMAILI	Fiti
8		
9		
10		
11		
12		
13		
14		
15		
16		
17		